

URDHËR
Nr.448, datë 5.7.2007

**PËR RIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT KOLEKTIV
TË SË DREJTËS SË AUTORIT NË FUSHËN E MUZIKËS DHE REGJISTRIMEVE
MEKANIKE TË SAJ, “ALBAUTOR”**

Duke marrë parasysh dokumentet e mëposhtme, bashkëlidhur:

a) kërkesën dhe dosjen me dokumentacionin e Agjencisë “Albautor” për ripërtëritjen e licencës;

b) propozimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtën e Autorit, nr.163 prot., datë 22.6.2007 për licencimin e kësaj agjencie në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj;

c) vlerësimin e Drejtorisë së Hartimit dhe Përafrimit të Legjislacionit dhe Shërbimeve Juridike të MTKRS, mbi ligjshmërinë e kërkesës dhe dosjes;

konstatoj se, në përmbushje të detyrimeve ligjore që burojnë nga ligji nr.9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, është kompetencë e Ministrit miratimi i ripërtëritjes së licencës së kësaj agjencie në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 124 pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 108, pika 1, dhe 109, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.9380 datë 28.4.2005 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”,

URDHËROJ:

1. Ripërtëritjen e licencës së Agjencisë së Administrimit Kolektiv të së Drejtës së Autorit në fushën e muzikës dhe regjistrimeve mekanike të saj, “ALBAUTOR”.

2. Afati i licencës është tre vjet nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

3. Urdhri i Ministrit nr.66, datë 30.3.2004 revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE
Ylli Pango



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT
MINISTRI

LIÇENCË

Nr. 4, datë 05/07/2007

Në mbështetje të ligjit nr. 9380, dt 28.04.2005 "Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Lidhura me të" dhe V.K.M nr. 232, datë 19.04.2006, "Për krijimin dhe funksionimin e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit" (ZSHDA), mbasi konstatohet se dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

VENDOSI:

Të licensojë subjektin "Albautor", si Agjensi e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Autorit, për degën e artit: "Muzika dhe të gjitha të drejtat e regjistrimeve mekanike të pronësisë artistike".
Njohur si person juridik me Vendim të Gjykatës së Tiranës, me nr.587/1 datë 15.07.2005.
Person i tatueshëm me nr. NIPT J81512003D, me seli: Rruga "Sami Frashëri", pall 20/1, shk 1,ap1, Tiranë.
Drejtor i Përgjithshëm: z.Neshat Tozaj.

Licenca është e vlefshme për një periudhë 3 (tri) vjeçare nga hyrja në fuqi e saj.

Kjo licencë hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare

Licenca duhet të ekspozohet në zyrat e ajënsisë.

MINISTRI
YLLI PANGO